

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Foda pritët ta rreshtojë Kosovën me 3-4-3 ndaj Austrisë
ADRESA	https://albeu.com/sport/foda-pritet-ta-rreshtoje-kosoven-me-3-4-3-ndaj-austrise/1029865/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 16:38:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 16:33:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c3bc7d36c46378f526d02766c3488c3e3cd5ed07500bc9a6773cbaca41ebf9c
TEKSTI	5eede6b310cd226a158aec2a8fe41d24bdbd8f34530d900e91668a8ab544fce7
PAMJA	72c403578327a32366d06a1875454b0ea952644ee26c4dd36797c762b58bc2ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d62870f65cecb4789841519bd697a9d428050a5d7136a9d0de18c163a0b94b9a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	622c8162b2af4b3a4f32b10517ab558346d08e6b143a7ec62e7fa674754e4065
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d62870f65cecb4789841519bd697a9d428050a5d7136a9d0de18c163a0b94b9a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Foda pritet ta rreshtojë Kosovën me 3-4-3 ndaj Austrisë



Kosova pritet të ruajë të njëjtën qasje taktike edhe në ndeshjen e sotme kundër Austrisë. Franco Foda mund të zgjedhë skemën 3-4-3, e cila gjatë aksioneve mbrojtëse do të shndërrohet në 5-4-1.

Arijanet Muric do të jetë në portë, ndërsa para tij pritet të luajnë Lumbardh Dellova, Ilir Krasniqi dhe Ron Raçi si pjesë e vijës me tre qendërmbrojtës.

Dion Gallapeni dhe Mërgim Vojvoda do të vendosen në krahë dhe do të kenë përgjegjësi të rëndësishme si në mbrojtje, ashtu edhe në ndërtimin e aksioneve. Në qendër të mesfushës do të veprojnë Leon Avdullahu dhe Veldin Hoxha.

Ermal Krasniqi e Baton Zabërgja pritet të pozicionohen në krahët e Vedat Muriqit, i cili do të jetë pika më e avancuar e sulmit. Me topin në zotërim, kjo vendosje do t'i lejojte Kosovës të kishte tre futbollistë në vijën e parë.

Kur skuadra të mos e ketë topin, ndryshimi taktik do të ishte i dukshëm. Gallapeni dhe Vojvoda do të tërhiqeshin pranë tre mbrojtësve, duke formuar një repart me pesë lojtarë përpara Muricit.

Në këtë situatë, Ermal Krasniqi, Leon Avdullahu, Veldin Hoxha dhe Baton Zabërgja do të krijojnë një rresht me katër mesfushorë, ndërsa Vedat Muriqi do të mbetet i vetëm në sulm. Detyra e tij do të ishte të mbante topin dhe të përfitonte nga hapësirat pas mbrojtjes së Austrisë.

Një organizim i tillë i jep Kosovës mundësinë të mbrohet në mënyrë kompakte dhe të reagojë shpejt përmes kundërsulmeve. Edhe ndaj Irlandës, përfaqësuesja përdori një sistem me tre qendërmbrojtës dhe krahë të avancuar, duke e mbyllur ndeshjen me fitore 1-0 dhe portë të paprekur.

Megjithatë, përballja me Austrinë kërkon përqendrim të veçantë në krahë. Ekipi i Ralf Rangnickut pritet të luajë me katër mbrojtës dhe të përdorë futbollistët ofensivë për të sulmuar vazhdimisht hapësirat mes reparteve.

të fundit /



Foda pritet ta rreshtojë Kosovën me 3-4-3 ndaj Austrisë



Vigenin akuzon Mickoskin për bllokimin e ndryshimeve...



Orteku godet ekspeditën në Himalaje, 10 alpinistë...



Misteri i balenave kashalot që fundosën anijet: nga Essex-i te...



Haxhiu apel grave: Mos i shtyni kontrollet për kancerin e gjirit



Noka akuzon Ramën se shmangu gazetarët: Duhej të jepte llogari...



Shpërthimi tragjik në Greqi, mbërrin në Athinë të afërmit e ka...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Austria e nisi këtë edicion me fitoren 3-1 ndaj Izraelit dhe krijoi shumë raste, ndaj faza mbrojtëse do të jetë një nga elementet vendimtare për Kosovën.

Pas rikuperimit të topit, Kosova mund ta shfaqë një version më ofensiv të kësaj skeme. Ekipi mund të kalojë menjëherë nga 5-4-1 në 3-4-3, me Gallapenin dhe Vojvodën që avancojnë në krahë, ndërsa Krasniqi e Zabërgja afrohen pranë Muriqit.

Foda synon kështu të ruajë idenë që dha rezultat ndaj Irlandës, por duke e përshtatur atë me mënyrën e lojës së Austrisë. Sfida kryesore për Kosovën do të jetë të mos qëndrojë për një kohë të gjatë e tërhequr në 5-4-1 dhe të shfrytëzojë në kohën e duhur shpejtësinë e lojtarëve të krahut për të dalë në sulm.

Shtuar më 27.09.2026 18:33

Tags: [Kombëtarja e austrisë](#), [Kombëtarja e kosovës](#), [Liga e Kombeve](#)



Affengruber realizon për Austrinë, Kosova mbetet në disavantazh



Suksesi ndaj Bjellorusisë, hapi i parë pozitiv; Kombëtarja përgatitet për...



BILD rikthehet te Erblin Osmani: Gjermania mund të pendohet për humbjen...



Atdhe Nuhiu sqaron pse Edon Zhegrova e nis nga stoli ndaj Austrisë



Austria dhe Kosova me formacionet zyrtare: Zhegrova nis nga stoli,...



Asllani shkëlqen ndaj Bjellorusisë, pas tij renditen Hysaj e Gjimshti! Seferi ...



Atdhe Nuhiu, figura që bashkon futbollin e Kosovës me atë të Austrisë



Kur shqiptarët bashkohen, nderohet UÇK-ja – "Plisat" mbledhen në Prishtinë për...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com